



Universiteti Shtetëror i Tetovës
Државен Универзитет во Тетово
Nr.-Bp. 02-3870/1
18.06.14
Tetovë - Tetovo

UNIVERSITETI SHETËROR I TETOVËS ДРЖАВЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

Në mbështetje të nenit 79-a të Ligjit për arsimin fillor, nenit 59 të Ligjit për arsimin e mesëm, nenit 100 të Ligjit për arsimin e lartë, dispozitave të Statutit të Universitetit Shtetëror të Tetovës, Senati i Universitetit Shtetëror të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 11.06.2014, sjell këtë:

RREGULLORE

Për kushtet dhe mënyrën e ndjekjes së mësimit, dhënien e provimeve dhe arritjen e përgatitjes pedagogjike-psikologjike dhe metodike në Fakultetin Filozofik

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohen dhe përcaktohen kushtet, kriteret dhe rregullat për ndjekjen e mësimit, dhënien e provimeve të programit studimor për fitimin e përgatitjes pedagogjike-psikologjike dhe metodike në Fakultetin Filozofik të Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Neni 2

Ky program studimor për marrjen e përgatitjes pedagogjike-psikologjike dhe metodike në Fakultetin Filozofik në Tetovë, është formë e përgatitjes për të gjithë kuadrot e profileve profesionale të cilët kanë kryer studime akademike përkatëse të ciklit të parë në fakultetet e drejtimeve joarsimore, përkatësisht në studimet të cilat nuk posedojnë drejtime arsimore, ndërsa përgatiten për punë edukative arsimore në shkollat fillore dhe të mesme.

II. REGJISTRIMI DHE ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 3

Kandidati regjistrohet për ndjekjen e mësimit për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike në mujin shkurt, përkatësisht në muajin shtator, në periudhë të paraparë, përmes shpalljes së Konkursit nga Universiteti.

Të drejtë për regjistrim kanë të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer studime akademike përkatëse të ciklit të parë të cilat nuk kanë drejtime arsimore.

Neni 4

Me regjistrimin e studimeve kandidati fiton statusin e kandidatit për marrjen e

kualifikimit plotësues, përkatësisht përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike.

Neni 5

Ky cikël i studimeve organizohet në kohëzgjatje prej 1 (një) semestri, sipas kritereve të Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS).

Neni 6

Me përfundimin e këtyre studimeve, kandidati fiton **30 ECTS** kredi.

Neni 7

Për kandidatët e regjistruar, Fakulteti udhëheq dokumentacion përkatës për aplikim, regjistrim, punë praktike, për provime dhe dokumente të tjera për evidencë të të gjitha obligimeve të parapara sipas programit.

Neni 8

Ligjëratat dhe mësimi praktik realizohen gjatë një semestri, për të cilat kandidati mban (evidencë) ditar.

Mësimi praktik përbëhet nga ndjekja e ligjëratave në lëndët mësimore përkatëse, si dhe njohja me jetën në shkollë dhe pjesëmarrjen në realizimin e aktiviteteve të cilat zhvillohen.

Gjatë dy javëve të para të muajit dhjetor/maj, kandidatët janë të obliguar të realizojnë 6 orë, nga të cilat 3 orë vështrime kritike për orët e ndjekura mësimore dhe 3 orë mësimore të realizuara në mënyrë të pavarur nën mbikëqyrjen e profesorit-mentor dhe mësimdhënësit-mentor. Kryerja e mësimit praktik është kusht për dhënien e provimeve nga lëndët e obligueshme dhe zgjedhore.

Neni 9

Përgatitja pedagogjike-psikologjike dhe metodike përbëhet prej: 3 (tri) lëndëve të obligueshme: pedagogji, psikologji dhe metodikë, 2 (dy) lëndëve zgjedhore: dokimologjia shkollë, organizimi i shkollës, etika në arsim, metodika e punës edukative, komunikimi pedagogjik, arsimimi ndërkulturor dhe shumëkulturor dhe praktika pedagogjike në shkollë të mesme me së paku 45 ditë me gjithsej 45 orë mësimore.

Obligimet arsimore për secilën lëndë përbëhen nga: lëratat, ushtrimet, përgatitja e punimeve seminarike, esetë, aktivitetet projektuese, detyrat e shtëpisë dhe të ngajshme, në masë të përcaktuar me programin e lëndës.

Në mësimin praktik, kandidati ndjek dhe realizon mësim përmes vështrimeve praktike nga orët e ndjekura mësimore në mbikëqyrje të mentorit në shkollë.

Pas përfundimit të mësimit praktik, kandidati fiton 7 (shtatë) ECTS kredi.

Numri i orëve mësimore për lëndët është nga 75 orë dhe nga 75 orë për

aktivitetet tjera të parapara me programin e lëndëve të obligueshme për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike.

Për secilin provim të dhënë nga lëndët mësimore të obligueshme, kandidati fiton 5 ECTS kredi.

Numri i orëve mësimore për lëndët zgjedhore është nga 60 orë mësimore dhe 60 orë për aktivitetet tjera të parapara në programet e këtyre lëndëve, ku për secilin provim të dhënë fitohet nga 4 (katër) ECTS kredi.

Neni 10

Ligjëratat dhe ushtrimet mbahen gjatë muajit tetor, nëntor dhe dhjetor, përkatësisht gjatë muajve mars, prill dhe maj.

Neni 11

Dhënia e provimeve kryhet në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtat kushte si në studimet e rregullta.

Neni 12

Dhënia e provimeve realizohet në muajin dhjetor/maj, për lëndët mësimore: psikologji dhe pedagogji, ndërsa dhënia e këtyre provimeve është kusht për dhënien e provimit nga lënda e Metodikës.

Dhënia e provimeve mund të realizohet edhe në kontinuitet gjatë zhvillimit të procesit mësimor (përmes kolokviumeve dhe formave të tjera), ose në tërësi pas përfundimit të semestrit, në afatet e paraparë për mbajtjen e provimeve në afatet e rregullta të cilat organizohen në fakultet (sesioni dimëror, veror dhe vjeshtor).

Shumën e paraparë të kompensimit që e paguan kandidati e përcakton ministri përkatës për Arsim dhe Shkencë.

Neni 13

Pas dhënies së provimeve për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike, institucioni i arsimit të lartë kandidatin i jep certifikatë.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Kandidatët e regjistruar për rikualifikim pedagogjik-psikologjik dhe metodik përpara sjelljes së Rregullores për mënyrën e ndjekjes së mësimin, dhënies së provimeve për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike, si dhe mënyrën e akreditimit të

institucioneve të rasimit të lartë (Gazeta zyrtare e RM, nr. 56, e datës 27 mars 2014), mund t'i kryejnë studimet me dhënien e tri provimeve të prapara (pedagogji, psikologji dhe metodikë), rikualifikimi në dy lëndë zgjedhore nga programi i ri studimor për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike dhe realizim të mësimit praktik në kohëzgjatje prej 45 ditësh në shkollë të mesme/përkatësisht shkollë fillore.

Neni 15

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e sjelljes së saj.

Rektori i
Universitetit Shtetëror të Tetovës

Prof. Dr. Vullnet Ameti

